

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E FINANCAVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201-26-4951-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Pastrimi dhe mirembajtja e objektit privat me qira (te Siriusi)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" AMBIENTI " SH.P.K.
NUI	601279707
Adresa	Prishtine, Mati 1, Rruga B, Obj. Inxhiniering, H 2, Nr 2.
Vendi	Kosove, Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Veton Krasniqi
Adresa elektronike	shpk.ambienti@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	14.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Pastrimi dhe mirembajtja e objektit privat me qira (te Siriusi)

Ankes per Mos Plotesimin e Kerkeses per Rishqyrtim Ministria Financave

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ankes per Mos Plotesimin e Kerkeses per Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dosjes së Tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues, pasi kriteret e përcaktuara nuk sigurojnë në mënyrë të mjaftueshme që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin

teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Dosja e tenderit nuk përmban kërkesa të qarta lidhur me posedimin në pronësi, qira ose përdorim të ligjshëm të pajisjeve dhe mekanizmave të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të pastrimit. Duke pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara, Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë dëshmi për pajisje profesionale, si makineri industriale për larjen dhe pastrimin e sipërfaqeve, fshesa industriale, pajisje për pastrimin e xhamave në lartësi, vinç ose platformë ngritëse për qasje në sipërfaqe të larta, karroca profesionale për pastrim, pajisje për dezinfektim dhe mjete të tjera të nevojshme për realizimin e sigurt dhe cilësor të kontratës.

Mosparashikimi i këtyre kërkesave bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk garanton që operatori ekonomik fitues do të ketë kapacitetet reale teknike për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara. Autoriteti Kontraktues ka obligim që kriteret e kualifikimit t'i përshtatë me objektin e kontratës dhe të sigurojë se operatorët ekonomikë posedojnë resurset e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen e kontratës.

Mungesa e kërkesave për pajisje krijon rrezik serioz që kontrata t'i jepet një operatori ekonomik i cili nuk disponon mjetet e nevojshme për realizimin e shërbimeve, duke cenuar cilësinë e ekzekutimit të kontratës, përdorimin efikas të fondeve publike dhe interesin publik.

Për më tepër, në rastet kur kontrata përfshin pastrimin e xhamave ose sipërfaqeve në lartësi, mungesa e kërkesës për vinç, platformë ngritëse ose pajisje të tjera adekuate paraqet mangësi të rëndësishme teknike dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në sigurinë gjatë realizimit të kontratës.

Prandaj, kërkojmë që OSHP të konstatojë se Dosja e Tenderit nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të korrigjojë Dosjen e Tenderit duke përfshirë kërkesa të qarta dhe proporcionale për pajisjet dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, si dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave pas korrigjimit të dosjes.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Dosjes së Tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues, pasi kriteret e përcaktuara nuk sigurojnë në mënyrë të mjaftueshme që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin teknik

dhe profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Dosja e tenderit nuk përmban kërkesa të qarta lidhur me posedimin në pronësi, qira ose përdorim të ligjshëm të pajisjeve dhe mekanizmave të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të pastrimit. Duke pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara, Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë dëshmi për pajisje profesionale, si makineri industriale për larjen dhe pastrimin e sipërfaqeve, fshesa industriale, pajisje për pastrimin e xhamave në lartësi, vinç ose platformë ngritëse për qasje në sipërfaqe të larta, karroca profesionale për pastrim, pajisje për dezinfektim dhe mjete të tjera të nevojshme për realizimin e sigurt dhe cilësor të kontratës.

Mosparashikimi i këtyre kërkesave bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk garanton që operatori ekonomik fitues do të ketë kapacitetet reale teknike për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara. Autoriteti Kontraktues ka obligim që kriteret e kualifikimit t'i përshtatë me objektin e kontratës dhe të sigurojë se operatorët ekonomikë posedojnë resurset e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen e kontratës.

Mungesa e kërkesave për pajisje krijon rrezik serioz që kontrata t'i jepet një operatori ekonomik i cili nuk disponon mjetet e nevojshme për realizimin e shërbimeve, duke cenuar cilësinë e ekzekutimit të kontratës, përdorimin efikas të fondeve publike dhe interesin publik.

Për më tepër, në rastet kur kontrata përfshin pastrimin e xhamave ose sipërfaqeve në lartësi, mungesa e kërkesës për vinç, platformë ngritëse ose pajisje të tjera adekuate paraqet mangësi të rëndësishme teknike dhe mund të ndikojë drejtpërdrejt në sigurinë gjatë realizimit të kontratës.

Prandaj, kërkojmë që OSHP të konstatojë se Dosja e Tenderit nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të korrigjojë Dosjen e Tenderit duke përfshirë kërkesa të qarta dhe proporcionale për pajisjet dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, si dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave pas korrigjimit të dosjes.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.